



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republik of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISE - OPŠTINA VITINA

Primitur / Dërguar më / Data 16.07.2022			
Nr. Dokument Orig. Buz.	Numri Buz.	Shënim Buz.	Vlera Vrednost
02-0	35/02-1027		



Komuna e Vitisë
Opština Vitina
Municipality Vitina

Në bazë të nenit 13 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare Nr.28/2008, me nenin 11, paragrafi 11.2.5 të Statutit të Komunës së Vitisë Nr.01-013/491, të datës 21.04.2011, lidhur me neni 37 të Ligjit për Mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë Tjera, Ligji Nr.04/-L-027, dhe neni 26 të Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit Nr.03/-L-025, kryetari i komunës nxjerr këtë:

V E N D I M

për formimin e Komisionit Komunal për Parandalimin e Rrezikut nga Zjarri gjatë sezonit veror

I

Me këtë vendim, Kryetari i Komunës së Vitisë formon Komisionin Komunal për Parandalimin e Rrezikut nga Zjarri gjatë Sezonit Veror. Komisioni përbëhet prej pesë (5) anëtarësh dhe ka këtë përbërje:

1. Hetem Jakupi – Kryetar i Komisionit
2. Izer Salihu – Anëtar
3. Shqip Korrani – Anëtar
4. Avni Misni – Anëtar
5. Afrim Sylejmani – Anëtar

II

Detyrat dhe përgjegjësitë e anëtarëve të Komisionit, sipas pikës I të këtij vendimi, janë:

- Të punojnë me komunitetin për parandalimin e rrezikut nga zjarret (vetëdijesimi i qytetarëve);
- Të evidentojnë rastet e zjarreve, të identifikojnë pronarët e parcelave ku ka ndodhur zjarri, të raportojnë dhe të bëjnë kallëzim penal ndaj shkaktarëve të zjarreve;
- Të bashkëpunojnë ngushtë me Policinë, bashkësitë fetare dhe bizneset për zvogëlimin e rrezikut nga zjarret;
- Të monitorojnë fushatën e korrje-shirjeve dhe të bashkëpunojnë me Komisionin për Bujqësi për këtë proces;
- Të bëjnë vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga zjarri dhe të raportojnë në Drejtorinë për Shërbime Publike dhe Emergjencë (DSHPE).

III

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen Kryetari i Komunës dhe Drejtori i Drejtorisë për Shërbime Publike dhe Emergjencë të Komunës së Vitisë.

IV

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës së Vitisë.

Ky vendim i dorëzohet:

1. Anëtarëve të Komisionit;
2. DSHPE-së;
3. Arkivit;
4. Zyrës së Kryetarit.

